

Shtojca 13

AGJENCIA E SHËRBIMEVE FUNERALE FORMULARI I NJOFTIMIT TE FITUESIT

Nr.93/9 prot.

Date 11.03.2021

Për: Operatorin ekonomik "SHPRESA-AL"sh.p.k.

Adresa: Njësia Bashkiake Nr.9, Rruga "Urani Pano", mbrapa "Veve Center", Pallati Nr.11, Kati 2,

e-mail: shpresa.al@gmail.com

Procedura e prokurimit: Kërkesë për propozime

Numri i referencës së procedurës/lotit: REF-87435-02-17-2021

Përshkrim i shkurtër i kontratës: Blerje materiale ndertimi,si: rere, çimento, çakull, granil, hekur etj per nevoja te agjencise. Afati fillon nga data e nënshkrimit të kontratës dhe përfundon më datë 31.12.2021.

Publikime të mëparshme (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike: nr.26, date 22.02.2021

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit: çmimi më i ulët X oferta ekonomikisht më e favorshme

Njoftojme se, kane qenë pjesëmarrës në procedurë këta ofertues me vlerat përkatëse të ofruara:

1. Op.ekonomik "SHPRESA-AL"sh.p.k.

K31321021N

Emri i plotë i shoqërisë

numri i NIPT-it

Vlera 3 863 200 leke pa TVSH (tre milion e tetëqind e gjashtëdhjetë e tre mijë e dyqind) lekë pa TVSH.

(me numra dhe fjalë)

2. Op.ekonomik "MURATI"sh.p.k.

J66702413V

Emri i plotë i shoqërisë

numri i NIPT-it

Vlera 3 661 800 (tre milion e gjashtëqind e gjashtëdhjetë e një mijë e tetëqind) lekë pa TVSH.

(me numra dhe fjalë)

3. Op.ekonomik "VALONA KONSTRUKSION"sh.p.k.

K26330202E

Emri i plotë i shoqërisë

numri i NIPT-it

Vlera 4 000 000 (katër milion) lekë pa TVSH.

(me numra dhe fjalë)

Janë skualifikuar ofertuesit e mëposhtëm:

1. Op.ekonomik "MURATI"sh.p.k

J66702413V

2. Op.ekonomik "VALONA KONSTRUKSION"sh.p.k.

K26330202E

Përkatësisht për arsyet e mëposhtme:

*** Nga shqyrtimi i dokumentacionit administrativ ligjor te operatorit ekonomik "MURATI" sh.p.k ne sistemin e APP rezulton se:

- Ka plotesuar te gjitha kriteret e pergjithshme te kualifikimit.
- Ka keto mangesi ne kriteret e vecanta te kapacitetit ekonomik dhe financiar.

Kriteri 2.2/b: Ne DST ne shtojcen 8 “Kriteret e veçanta të kualifikimit” kapaciteti ekonomik dhe financiar kriteri 2.2/b eshte kerkuar:

“b) Kopje të deklaratave të xhiros vjetore të realizuar gjatë viteve 2018, 2019 dhe 2020, ku vlera mesatare e të tre viteve të jetë jo më vogël se vlera e fondit limit, të vërtetuar me një dokument të lëshuar nga administrata tatimore.

Në vërtetimin elektronik të Drejtorisë Rajonale Tatimore Dibër me Nr.T03588151, të paraqitur nga operatori ekonomik “MURATI” sh.p.k. ka të shënuar xhiron vjetore për vitin 2017-2018-2019. Mungon xhiro vjetore për vitin 2020 të kërkuar në dokumentet e tenderit.

Për sa më sipër, ofertuesi nuk ploteson kriterin 2.2/b të kapacitetit ekonomik dhe financiar për xhiron vjetore për tre vitet e fundit 2018 – 2019 - 2020. Ky kriter konsiderohet i papermbushur nga ofertuesi.

- Ka plotësuar të gjitha kriteret e veçanta të kapacitetit teknik.
- Ka plotësuar të gjitha kriteret të tjera.

Kriteret për kualifikim vendosen që ti shërbejnë autoritetit kontraktor për të krijuar një panoramë të përgjithshme të kapaciteteve dhe mundësive të operatorit për përmbushjen me sukses të kontratës. Autoriteti kontraktor do të konsiderojë një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, për sa kohë që ato janë në përputhje me natyrën dhe përmasat e kontratës.

Operatorët ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentat e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumenta, duhet të refuzohen si të papranueshme.

Në zbatim të nenit 53 pika 3 të ligjit nr.9643 datë 20.11.2006, “Për Prokurim Publik” (të ndryshuar) “Autoriteti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit.....”, për sa më sipër oferta e paraqitur nga operatori ekonomik “MURATI” sh.p.k shpallet e pavlefshme, pasi nuk ploteson të gjitha kriteret e kërkuara nga autoriteti kontraktor Agjencia e Shërbimeve Funerale në dokumentet e tenderit.

*** Nga shqyrtimi i dokumentacionit administrativ ligjor të operatorit ekonomik “VALONA KONSTRUKSION” sh.p.k në sistemin e APP rezultojnë se:

- Ka këto mangësi në kriteret e përgjithshme të kualifikimit.

Në DST, në shtojcën 5 “Deklaratë Mbi Përmbushjen e Kritereve Të Përgjithshme” përcaktohet se: “Operatori ekonomik _____ është i regjistruar në Qendrën Kombëtare të Biznesit dhe ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit. Në rastin kur ofertuesi është një organizatë jofitimprurëse, duhet të deklarojë se është i regjistruar si person juridik, sipas Ligjit Nr.8788, datë 07.05.2001 “Për Organizatat jo Fitimprurëse”.

Operatori ekonomik “VALONA KONSTRUKSION” sh.p.k ka paraqitur shtojcën 5, ku deklaron se: “Operatori ekonomik Valona Konstruksion shpk është i regjistruar në Qendrën Kombëtare të Biznesit dhe ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit. Në rastin kur ofertuesi është një organizatë jofitimprurëse, duhet të deklarojë se është i regjistruar si person juridik, sipas Ligjit Nr.8788, datë 07.05.2001 “Për Organizatat jo Fitimprurëse”.

Komisioni beri verifikimin e fushes se veprimtarise te ofertuesit “VALONA KONSTRUKSION” sh.p.k ne faqen zyrtare te QKB, ku rezulton se ofertuesi ka si objekt te veprimtarise se tij, punime ne fushen e ndertimit dhe jo tregtim te materialeve inerte apo te ndertimit, siç eshte edhe objekti i procedures se prokurimit qe zhvillon autoriteti kontraktor Agjencia e Sherbimeve Funerale.

Për sa më sipër, objekti i fushes se veprimtarise se ofertuesit nuk perfshin objektin e prokurimit per “Blerje materiale ndertimi”. Ky kriter konsiderohet i papermbushur nga ofertuesi.

- Ka keto mangesi ne kriteret e veçanta te kapacitetit ekonomik dhe financiar.

Kriteri 2.2/b: Ne DST ne shtojcen 8 “Kriteret e veçanta të kualifikimit” kapaciteti ekonomik dhe financiar kriteri 2.2/b eshte kerkuar:

“b) Kopje të deklaratave të xhiros vjetore të realizuar gjatë viteve 2018, 2019 dhe 2020, ku vlera mesatare e të tre viteve të jetë jo më vogël se vlera e fondit limit, të vërtetuar me nje dokument të lëshuar nga administrata tatimore.

Në vërtetimin elektronik te Drejtorise Rajonale Tatimore Vlore me Nr.T02967784, te paraqitur nga operatori ekonomik “VALONA KONSTRUKSION” sh.p.k ka të shënuar xhiron vjetore për vitin 2017-2018- 2019. Mungon xhiro vjetore per vitin 2020 te kerkuar ne dokumentet e tenderit.

Për sa më sipër, ofertuesi nuk ploteson kriterin 2.2/b te kapacitetit ekonomik dhe financiar për xhiron vjetore për tre vitet e fundit 2018 – 2019 - 2020. Ky kriter konsiderohet i papermbushur nga ofertuesi.

- Ka keto mangesi ne kriteret e veçanta te kapacitetit teknik

Kriteri 2: Ne DST ne shtojcen 8 “Kriteret e veçanta të kualifikimit” kapacitetit teknik kriteri 2 eshte kerkuar:

“2. Operatori ekonomik duhet të vërtetojë se disponon 2 mjete kamion me kapacitet mbi 3.5 ton për transportimin e mallrave sipas nevojave te autoritetit kontraktor. Mjetet te jene ne pronesi ose me qera shoqeruar me dokumentet:

A. Për mjetet ne pronesi duhet të paraqitet dokumenti që verteton regjistrimin e mjetit a) leje qarkullimi, b) certifikaten e kontrollit teknik (i vlefshem), c) siguracionin e mjetit (i vlefshem) dhe d) certifikat transport mallrash nga pushteti vendor (e vlefshme).

B. Për mjetet e siguruara me qera, dokumenti që vërteton regjistrimin e mjetit a) leje qarkullimi, b) certifikaten e kontrollit teknik (i vlefshem), c) siguracionin e mjetit (i vlefshem) dhe d) certifikat transport mallrash nga pushteti vendor (e vlefshme), si dhe duhet te shoqerohet me kontratën noteriale të qerasë, e vlefshme për të gjithë periudhën e realizimit të kontratës objektit te këtij prokurimi. ”

Nga verifikimi i dokumentave rezulton se ofertuesi “VALONA KONSTRUKSION” sh.p.k ka marre me kontrate qeraje me nr.rep.2020, kol.227, date 07.12.2020, disa mjete nga shoqeria “DAST”, ku ne piken 4 te kontrates eshte percaktuar afati si vijon : “Kontrata e qerases lidhet per nje afat prej 1 vjeçar, duke filluar nga data e firmosjes se kontrates nga palet. ” , referuar kontrates data e lidhjes eshte 07.12.2020 dhe afati i mbarimit te saj eshte data 07.12.2021. Sipas kerkeses se autoritetit kontraktor, kontrata e qerases se mjeteve duhet te jete e vlefshme për të gjithë periudhën e realizimit të kontratës objektit te këtij prokurimi, perkatesisht deri me date 31.12.2021.

Per sa u parashtroa me siper, ofertuesi nuk e ploteson kriterin 2, qe disponon 2 mjete kamion për transportimin e mallrave sipas nevojave te autoritetit kontraktor. Ky kriter konsiderohet i paperbushur nga ofertuesi.

Kriteri 3: Ne DST ne shtojcen 8 “Kriteret e veçanta të kualifikimit” kapaciteti teknik ne kriterin 3 ka kerkuar :

“Çertifikaten ISO 9001-2015 per Sistemin e Menaxhimit te Cilesise te akredituar nga institucione shtetore vendase ose te huaja, objekti i se ciles te jete ne perputhje me objektin e prokurimit (e vlefshme).”

Objekti i prokurimit i kesaj procedure eshte “Blerje materiale ndertimi”, pra kemi te bejme me nje kontrate te furnizimit te mallrave, te cilat jane materiale ndertimi si: çimento, çakell, hekur, rere, gelqere, etj.

Operatori ekonomik “VALONA KONSTRUKSION” sh.p.k ka paraqitur ne sistem Çertifikaten EN-ISO 9001:2015 me numer AQS/Q/61772020 per sistemin e menaxhimit te cilesise me permbajtjen sa me poshte:

“Ndertim, rikonstrukcion dhe mirembajtje objekte civile dhe industrial, rruge, autostrada, mbikalime, hekurudha, tramvaj, metro, pista aeroportuale, ura dhe vepra arti, ujesjellesa, kanalizime, gazsjellesa, vajsjellesa, vepra kullimi e vaditje, impiante te grumbullimit dhe trajtimit te mbejteve urbane dhe nenstacione per prodhimin dhe transmetimin e energjise elektrike, kabina te transformatoreve, linja te tensionit te larte, te mesem dhe te ulet, veshje fasade, punime thellimi ne uje. Ndertimimpiante te sinjalistikes ndriçuese te trafikut, sinjalistikes rrugore jo ndriçuese, barrier dhe mbrojtje rrugore. Shpime gjeologo-inxhinierike, puse dhe shpime per uje.”

Referuar permbajtjes se çertifikates ISO 9001-2015 te Operatorit ekonomik “VALONA KONSTRUKSION” sh.p.k nuk rezulton qe te jete çertifikuar per menaxhim te cilesise per tregtim te materialeve te ndertimit, sipas objektit te prokurimit.

- Ka plotesuar te gjitha kriteret e tjera:

Kriteret per kualifikim vendosen qe ti sherbejne autoritetit kontraktor per te krijuar nje panorame te pergjithshme te kapaciteteve dhe mundesise se operatorit per permbushje me sukses te kontrates. Autoriteti kontraktor do te konsideroje nje oferte te vlefshme, vetem nese ajo eshte ne perputhje me te gjitha kerkesat dhe specifikimet e percaktuara ne njoftimin e kontrates dhe ne dokumentet e tenderit, per sa kohe qe ato jane ne perpjestim me natyren dhe permasat e kontrates.

Operatoret ekonomike jane te detyruar te pergatisin ofertat, ne perputhje me kerkesat e percaktuara ne dokumentat e tenderit dhe ofertat qe nuk pergatiten ne perputhje me keto dokumenta, duhet te refuzohen si te papranueshme.

Ne zbatim te nenit 53 pika 3 te ligjit nr.9643 date 20.11.2006, “Per Prokurim Publik” (te ndryshuar) “Autoriteti kontraktor, ne zbatim te pikes 4 te ketij neni, vlereson nje oferte te vlefshme, vetem nese ajo eshte ne perputhje me te gjitha kerkesat dhe specifikimet e percaktuara ne njoftimin e kontrates dhe ne dokumentet e tenderit....”, per sa me siper oferta e paraqitur nga operatori ekonomik “VALONA KONSTRUKSION” sh.p.k shpallet e pavlefshme, pasi nuk ploteson te gjitha kriteret dhe specifikimet e kerkuara nga autoriteti kontraktor Agjencia e Sherbimeve Funerale ne dokumentet e tenderit.

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, Operatorin ekonomik “ SHPRESA-AL”sh.p.k.
Adresa: Njësia Bashkiake Nr.9, Rruga "Urani Pano", mbrapa "Veve Center", Pallati Nr.11, Kati 2,
e-mail: shpresa.al@gmail.com se oferta e paraqitur, me një vlerë të përgjithshme prej 3 863 200
leke pa TVSH (tre milion e tetëqind e gjashtëdhjetë e tre mijë e dyqind) lekë pa TVSH / pikët
totale të marra [_____]është identifikuar si oferta e suksesshme.

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë *Agjencisë së Shërbimeve Funerale me adresë:Rr.Durrësit, nr.132, Tiranë* sigurimin e kontratës, siç parashikohet në dokumentat e tenderit, brenda 5 (pesë) ditëve nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi.

Në rast se nuk pajtoheni me këtë kërkesë, ose tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës, kontrata do t'i akordohet ofertuesit vijues në klasifikimin përfundimtar, oferta e të cilit është dorëzuar me një vlerë të përgjithshme prej [vlera përkatëse e shprehur në fjalë dhe shifra], siç parashikohet në nenin 58 të Ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë 03.03.2021

Ankesa: Nuk ka patur ankesa.

(nëse ka) ka marrë përgjigje në datë _____

TITULLARI I AUTORITETIT KONTRAKTOR

Raimonda Shino